



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:295250

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06612236

Ac.nr.1539/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ç.S, i lindur në S....., të cilin me autorizim e përfaqëson Xh.B, avokat nga P....., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në P....., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega më Suharekë, C.nr.727/2019, i datës 01.02.2022, në seancën e kolegjit më datë 16.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega më Suharekë, C.nr.727/2019, i datës 01.02.2022, në pikën II (dy) të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial për shëmtimin e shkallës së mesme dhe dëmit material për ndihmën nga personi i tretë, NDRYSHOHET dhe gjykohet si në vijim:

-DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në P..... që paditësit për shkak të shëmtimit të shkallës së mesme t`ia paguajë shumën prej 3.000 Euro dhe për ndihmën nga personi i tretë shumën prej 900 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara për këto lloje të dëmit, refuzohet e pathemeltë,

II. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega më Suharekë, C.nr.727/2019, i datës 01.02.2022, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë në pikën I, II të dispozitivit për dëmin jomaterial për dhimbje fizike, për zovgëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe frikës së përjeuar, si dhe për dëmin material për ushqimin e përforcuar, për barnat sipas faturave dhe fitimin e munguar, kamatën e gjykuar, në pikën III të dispozitivit dhe në pikën IV të dispozitivit për shpenzimet e procedurës kontestimore, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.727/2019, i datës 01.02.2022, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Ç.S, i lindur në S....., përfaqësuar nga av. Xh.B nga P....., ashtu që:

II. OBLIGOHET e paditura, Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në P....., që paditësit t’ia kompenzon:

a) Në emër të dëmit jo material:

Për shkaktimin e dhembjeve fizike shumën prej 5,000.00 euro.

Për shkaktimin e shëmtimit të mesëm shumën prej 6,000.00 euro.

Për shkaktimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 10,000.00 euro.

Për shkaktimin e frikës së përjetuar shumën prej 4,000.00 euro.

Gjithsej shumën prej 25,000.00 euro.

b) Në emër të dëmit material:

Për ndihmën nga personi i tretë shumën prej 1.000.00 euro.

Për ushqimin e përforcuar shumën prej 1.200.00 euro.

Për barna sipas faturave – kuponave fiskale shumën prej 500.40 euro.

Për fitimin e munguar nga dita e parashtrimit të padisë nga data 23.12.2019 e deri në nxjerrjen e këtij aktgjykimi më 27.01.2022, shumën prej 4,834.33 euro, si dhe në të ardhmen deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj nga 84.32 euro.

Gjithsej shumën prej 7,534.73 euro.

Të gjitha këto në emër të dëmit jo material dhe material në shumën e përgjithshme prej 32,534.73 euro, pala e paditur obligohet që t’ia kompenzon palës paditëse me kamatëvonesë ligjore vjetore në shkallë prej 8%, e cila për dëmin jo material fillon të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 27.01.2022, ndërsa për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë më 23.12.2019, e gjer në pagesën definitive, në afatin ligjor prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën përmbarim të dhunshëm.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të aprovuara si në pikën II të Dispozitivit të këtij Aktgjykimi që përmban germën a) dhe b), REFUZHET si e pabazuar.

IV. OBLIGOHET pala e paditur që paditësit, t’ia kompenzon shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,827.00 euro, sipas afatit parativ të paraparë te kërkesa kryesore, përkatësisht te pika II e Dispozitivit të këtij Aktgjykimi”

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t’ia kthejë në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në përgjigje në ankesë, i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës të paraqitura në ankesë, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 20.12.2019, ka ushtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S....., me seli në P....., ndërsa me parashtresën e datës 09.11.2021 ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë, duke kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të ndodhur më datë 11.11.2019, andaj kërkon kompensimin e dëmit në shumat e cekura si në precizimin e kërkesëpadsisë me parashtresën e datës 09.11.2021, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e shkaktimit të dëmit e gjerë në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata duke vepruar sipas padsisë së paditësit dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.727/2019, i datës 01.02.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë, ndërsa lartësinë e kërkesëpadsisë gjykata e ka vërtetuar me nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga ekspertët Dr. Sh.D-kirurg torakal, Dr. Xh.S-ortoped/traumatolog dhe psikiatri Dr.J.Z, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional drejtpërdrejtë në seancën e dt. 15.07.2021, duke u deklaruar për natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit, ka vërtetuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore të karakterizuara me thyerje në shumë fragmente të filxhanit të kordhikulës së majtë dhe të djathtë, zhvendosje traumatike e kordhikulës së majtë, gjakmbledhje me bllokim ajror traumatik të mushkërisë së djathtë, ndrydhje gjakderdhëse brenda mushkërore e dyanshme, thyerja e brinjëve majtas, gërvishtje në regjionin e të dy duarve, të cilat lëndime janë manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 minuta, dhembje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditë, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 42 ditë dhe të intensitetit të ulët janë edhe sot e kësaj dite, shkalla e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është 23.05%, paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje prej 90 ditësh, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 120 ditësh, shëmtimi trupor është i shkallës së mesme, Nga ekspertiza e ekspertit mjekësor të psikiatrisë, Dr. J.Z, të nxjerrë në seancën gjyqësore të datës 15.07.2021, gjykata ka provuar faktin se paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej 2 deri në 3 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në

kohëzgjatje prej 2 deri në 4 ditë, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 8 javë, të intensitetit të ulët, e cila vazhdon ende, herë pas here dhe atë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Nga ekspertiza mjekësore për vlerësimin e aftësisë së punës, të hartuar nga më 21.09.2021, nga eksperti dr. Xh.Sh, gjykata ka vërtetuar faktin se zvogëlimi i aftësisë së përhershme punuese për paditësin është në shkallë prej 29%, ndërsa nga ekspertiza e aktuaristikës të hartuar më 02.11.2021, nga ekspertja G.Sh, gjykata ka vërtetuar faktin se fitimi i humbur për periudhën prej 11.11.2019-02.11.2021, është në shumë prej 4,834.33 euro, si dhe pas datës 03.11.2021 e arrin vlerën prej 84,32 euro apo e kapitalizuar në total prej 24,192.00 euro. Shuma e pagesës prej 84.32 euro paraqitet për rentën (fitimin e munguar) në të ardhmen, pra pas momentit të nxjerrjes së këtij aktgjykimi, i cili rezulton nga zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm punues në shkallë prej 29% bazuar në mendimin profesional të ekspertit të mjekësisë së punës, Dr. Xh.Sh. Gjukata nuk vendosi që të shkonte me rentë të kapitalizuar, pasi nuk ekziston rreziku i mos ekzistimit të palës së paditur, respektivisht pala e paditur nuk gjendet në procedurë të falimentimit, që për palën paditëse ky fakt do të ndikonte në rrezikimin e kësaj të drejte po që se do të shkohej me rentë mujore. Gjukata nuk mundi të përkrahte argumentimet e palës së paditur që kjo e drejtë nuk i përket / takon palës paditëse, për shkak se në momentin e aksidentit, i njëjti (paditësi) nuk ka qenë në marrëdhënie pune, për arsye se nga lëndimet e pësuar me fajin e të paditurës, iu është zvogëluar aktiviteti punues në shkallë 29%, e që lidhet direkt me themelimin e marrëdhënies së punës, ashtu që kjo formë e dëmit duhet ti pranohet paditësit. Sa i përket shpenzimeve të tjera, e që konsiston në barnat që është dashur paditësi t'i blej për shërimin e shëndetit, gjykata këtë kërkesë e gjeti të bazuar dhe aprovoi në tërësi, ngase paditësi ka prezantuar prova-dëshmi që provojnë faktin se ka shpenzuar këto mjete.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit jo material dhe material, gjykata i vlerësoi si të pabazuara dhe jo të provuara nga paditësi, pasi që lartësia e tyre nuk ishte në harmoni me synimet (qëllimet) e dëmit të shkaktuar në njërin anë dhe kompensimit në anën tjetër, si dhe qëllimin shoqëror, për të cilat paditësi fillimisht do të duhej të provonte këto fakte, e pastaj të kishte bazë e drejta subjektive e pretenduar për kompensim. Gjukata po ashtu vendosi që të refuzonte edhe kërkesëpadinë në lidhje me rehabilitimin, të paraqitur në shumë prej 1,000.00 euro, pasi që ky detyrim është përmbushur nga pala e paditur, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar nëpërmjet provës: akontacionit, në vlerë prej 1000 euro, dt. 31.01.2020.

Gjukata e shkallës së parë, bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë e saj e bazoi në nenin 136.1, 137, 169, 170, 172 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 21, 23 dhe 26.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për kamatën e gjykuar vendosi në pajtim me nenin 378 dhe 382 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 265/2020 të datës 02.12.2020, ndërsa për shpenzimet procedurale gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 449 lidhur me 452.1 të LPK-së.

Gjukata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare

në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, përveç në pjesën ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika o) për arsye se gjykata e shkallës së parë ka vendosur brenda kufijëve të kërkesës së palës paditëse, e sipas precizimit të kërkesëpadisë i bërë pas ekspertizave mjekësore. Paditësi në padi ka cekur se vlera e kontestit ka qenë në shumën prej 4.000€, por që në të njëjtën padi, konkretisht në petitumin e saj, ka theksuar se *“kompensimi i dëmit në atë lartësi, që do të ndryshohet vetëm pas dhënies së mendimit nga ekspertët mjekësor të gjitha këto më kamatë ligjore”*, nga çka rezulton se e kishte rezervuar të drejtën që të bëjë precizimin e kërkesëpadisë pas dhënies së mendimit nga ana e ekspertëve mjekësorë, ngase pa mendimin e ekspertëve mjekësor të cilët përcaktojnë: natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, përcaktimin e shkallës së shëmtimit trupor, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të punës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar nuk ka mundur as të kërkojë vlerën për këto kategori të dëmeve dhe për këtë arsye e ka rezervuar të drejtën që pas ekspertizave mjekësore të deklarohet lidhur me lartësinë për dëmin e shkaktuar, andaj kjo gjykatë vlerëson se është veprim i domosdoshëm procedural i paditësit që pas ekspertizave mjekësore të bëjë precizimin e kërkesëpadisë, duke precizuar shumat për secilën kategori të dëmit material dhe jomaterial, e që kështu ka vepruar paditësi me parashtresën e dt. 09.11.2021, duke e precizuar secilën formë të dëmit të kërkuar, e duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, e më detajisht si në parashtresë.

Lidhur me pretendimet ankimore të të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, nga ku baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizave mjekësore, mendimit profesional ekspertëve të mjekësisë: Dr. Sh.D-kirurg torakal, Dr. Xh.S-ortoped/traumatolog dhe psikiatri Dr.J.Z, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional, duke u deklaruar për llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, përcaktimin e shkallës së shëmtimit trupor, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të punës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, ndërsa sa i përket fitimit të munguar-rentës për periudhën e arritur dhe periudhën e ardhshme është bazuar në ekspertizat e ekspertëve nga lëmia e punës Dr. Xh.Sh dhe e aktuaristikës G.Sh, respektivisht kanë përcaktuar lëndimet dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit të dt. 11.11.2019, si dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me fitimin e munguar-rentën, se kjo e drejtë duhet ti njihet paditësit, ngase duke u bazuar në moshën e tij të re edhe pse në momentin e aksidentit, i njëjti nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por që nga lëndimet e pësuar me fajin e të paditurës, iu është zvogëluar aktiviteti punues në shkallë 29%, e që lidhet direkt me themelimin e marrëdhënies së punës, ashtu që kjo formë e dëmit duhet ti pranohet paditësit, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e Apelit i pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke konsideruar se shumta e gjykuar për dëmin jomaterial për shëmtimin trupor të shkallës së mesme (bazuar në ekspertiza mjekësore) është e lartë, prandaj kjo gjykatë, duke marrë për bazë pretendimin ankimor të të paditurës, por duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në kuptim të nenit 195 par.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, në pjesën e kërkesëpadsisë së paditësit që i referohet dëmit jomaterial, ashtu që për shëmtimin trupor të shkallës së mesme e ka gjykuar në shumën prej 3.000 Euro, duke konsideruar se shumta e gjykuar, tani është në proporcion me shkallën e shëmtimit trupor, ashtu që gjykata e shkallës së lartë me aplikimin e praktikës gjyqësore ka arritur në përfundim se shpërblimi i gjykuar si në pikën I të dispozitivit është në proporcion me të keqen e shkaktuar dhe ka arsyetuar se lartësia e kërkesës më tepër se shumta e gjykuar nuk iu shkon përshtati synimeve për të cilat ka për qëllim kompensimi. Andaj, Gjykata e Apelit është bazuar në kuptimin e dispozitës së nenit 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së ku parashihet se : *1. Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, si dhe nga mungesa e dëmit material e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”,* andaj mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit vlerëson se shumta e ndryshuar për dëmin jomaterial është në përputhje me të mirën e shkelur, ndërsa shumën e kërkuar për këtë kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar e ka refuzuar si të pabazuar me arsyetim se nuk është proporcionale me të mirën e shkelur.

Gjykata e Apelit, poashtu e ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar, e duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në pjesën e kërkesëpadsisë për dëmin material për ndihmën dhe kujdesin e huaj, duke e bazuar në ekspertizën mjekësore se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 90 ditësh, andaj edhe kjo gjykatë e ka gjykuar shumën prej 900 Euro, duke konsideruar se është në proporcion me ditët që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj, e që kjo shumë është e pranueshme edhe në praktikën e mirë gjyqësore, por njihet edhe nga kompanitë e sigurimeve, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadsisë për këtë kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar refuzohet e pathemeltë, ngase është joproporcionale me ditët që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj.

Sa i përket pjesës së vërtetuar të kërkesëpadsisë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për dëmin jomaterial për dhimbje fizike, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe frikës së përjeuar, si dhe për dëmin material për ushqimin e përforcuar, për barnat sipas faturave dhe fitimin e munguar, këto shumta i vërtetoi, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore dhe të aktuaristikës, të ekspertëve, të cilët në mënyrë të qartë kanë dhënë mendimin e tyre për llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore që ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të punës,

andaj shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë në proporcion me frikën e përjetuar dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, ndërsa për dëmin material është bazuar në ekspertizën mjekësore të cilët e kanë përcaktuar nevojën dhe kohëzgjatjen e paditësit për ushqim të përforcuar, si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit, për 120 ditë, andaj shuma e gjykuar është në proporcion me ditët që ka pasur nevojë paditësi për ushqim të përforcuar, që gjen mbështetje edhe në praktikën e mirë gjyqësore dhe të kompanive të sigurimeve, ndërsa lartësinë e shpenzimeve të mjekimit gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në bazë të provave-faturave që gjenden në lëndë, ndërsa me ekspertizë të punës dhe të aktuaristikës është vendosur për fitimin e munguar, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në moshën e paditësit të re, edhe pse në momentin e aksidentit, nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por që nga lëndimet e pësuar me fajin e të paditurës, iu është zvogëluar aktiviteti punues në shkallë 29%, e që lidhet direkt me themelimin e marrëdhënies së punës, ashtu që ia ka pranuar këtë formë të dëmit, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta.

Mbi bazën e këtyre provave, gjegjësisht ekspertizave të lartcekura është provuar fakti se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore nga pala e siguruar e palës së paditur, e të cilat prova kanë qenë determinonte për vendosje lidhur me lartësinë e dëmit që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit të komunikacionit, andaj këto prova i kanë shërbyer gjykatës si bazë në drejtim të orientimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, e që një vlerësim të tillë e pranon edhe Gjykata e Apelit si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit lidhur me pretendimet e ta paditurës për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nuk qëndrojnë për faktin se me nenin 169 paragrafin 1 të LMD-së, parashihet se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.”* Në paragrafin 2, parashihet që: *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.”* Në paragrafin 3, parashihet që: *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”* Në paragrafin 4, parashihet që: *“Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”* Në nenin 170 të LMD-së, parashihet se: *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur për pagesë që nga momenti i shkakimit të dëmit.”* Në nenin 172 par. 1 të LMD-së parashihet se: *“Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.”* Ndërsa në paragrafin 2, parashihet që: *“Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”,* ndërsa në bazë të nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet që: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë,*

vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.” Në nenin 23 të saj parashihet që: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”* Ndërsa në nenin 26 par. 2 të Kushtetutës parashihet që: *“Të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin.”* Ndërsa në nenin 9 të LMD-së, parashihet që: *“Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit.”* Ndërsa në nenin 136 par. 1 të LMD-së, parashihet që: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Ndërsa në nenin 137 të LMD-së, parashihet që: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*, duke ardhur në përfundim se paditësit si pasojë e këtij aksidenti të komunikacionit, i cili ka ndodhur me fajin e të siguarit të të paditurës, fakt i cili nuk ishte kontestuar nga e paditura, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia përmbushë detyrimin, në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial.

Gjykata e Apelit, vlerëson se kamata e gjykuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ku gjykata e shkallës së parë drejtë e ka gjykuar kamatën si për dëmin jo material ashtu edhe për dëmin material, duke vepruar sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e Apelit, nuk i pranon pretendimet ankimore të të paditurës, duke vlerësuar se vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është llogaritur drejtë, ku gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të saj, i ka specifikuar shpenzimet një nga një dhe i ka arsyetuar, e duke marrë parasysh se aksidenti ka ndodhur me fajin e të siguarit të të paditurës, edhe gjykata e shkallës së dytë gjeti se shpenzimet e procedurës janë llogaritur drejtë e që përfshijnë shumën e cekur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, e që është në përputhje me veprimet e ndërmarra procedurale të nevojshme dhe të domosdoshme në këtë çështje juridike, e në mbështetje me dispozitat ligjore të nenit 452.1 të LPK.,

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e ka ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar në kufijtë e pretendimeve ankimore të palës së paditur.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1539/2022, me datë 16.12.2024

Kryetare e kolegjit

Numri i lëndës: 2019:295250
Datë: 17.12.2024
Numri i dokumentit: 06612236

Nora Bllaca-Dula d.v,